



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË INDUSTRIJËS
DHE ENERGJISË

Nr. 5442/2 prot.

Tiranë, më 27. 3. 2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1021, datë 13.06.2007.

SHOQËRISË "K - 12" SH.P.K
Rruga "Reshit Çollaku", Vila nr.24, Pogradec.

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi "Bajram Curri", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE
EMERGJENCAT NË MINIERA (AKSEM), ISH RISHM
Rruga "Lord Bajron", Laprakë, Tiranë.

Shoqëria "K-12" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1021, datë 13.06.2007, për mineral hekur nikeli e nikel silikat, në objektin "Xhumagë – Liqeni i Kuq", Librazhd, Qarku Elbasan.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së, me shkresën nr.5845, datë 27.07.2017, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.5442, datë 02.08.2017, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.1021, datë 13.06.2007, për mineral Hekur Nikeli e Nikel Silikat, në objektin "Xhumagë – Liqeni i Kuq", Librazhd, Qarku Elbasan, për arsye se nuk janë kryer pagesat e rehabilitimit vjetor për vitet 2015, 2016 dhe 2017 në shumën 2 984 106 lekë, përcaktuar sipas pikës 5, të nenit 31, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Leja juaj është dhënë në bazë të Ligjit Nr.7796, datë 17.02.1994, "Minerim të Shqipërisë" të ndryshuar që është shfuqizuar me Ligjin Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Sipas nenit 57, pika 2 dhe 3, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Shkresa me propozimi e AKBN-së i është dërguar edhe shoqërisë suaj për dijeni, dhe pas këtij njoftimi ju keni bërë kërkesë, në adresën e Institucionit tonë, me nr.11, datë 25.08.2017, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë me nr.5442/1, datë 28.08.2017, duke kundërshtuar propozimin e mësipërm e keni bërë argumentimin

tuaj, për arsye për të cilën e kundërshtoni këtë propozim. Në kërkesën tuaj thoni se keni kërkuar rilllogaritjen e garancisë vjetore të rehabilitimit të mjedisit, nga struktura përgjegjëse e AKBN-së, pasi sipërfaqja e shfrytëzimit është shumë më e vogël se ajo e lejes.

Sipas pikës 7, nenit 31, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, për lejet e dhëna më parë, duhet të përcaktohet vlera e rehabilitimit vjetor të mjedisit, sipas procedurave të përcaktuara me akte nënligjore, që kanë dalë në zbatim të ligjit të sipërcituar. Kjo vlerë është përcaktuar për lejen nr.1021, datë 13.06.2007, për mineral hekur nikeli e nikel silikat, në objektin "Xhumagë – Liqeni i Kuq", që ju zotëroni, dhe sipas legjislacionin që është në fuqi nuk mund të korrigjohet për tu zvogëluar.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur në gërmën "ç", të pikës 1, të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet) të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1021, datë 13.06.2007, për mineral hekur nikeli e nikel silikat në objektin "Xhumagë – Liqeni i Kuq", Librazhd, Qarku Elbasan, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju vëmë në dijeni se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1021, datë 13.06.2007, për mineral hekur nikeli e nikel silikat, në objektin "Xhumagë – Liqeni i Kuq", Librazhd, Qarku Elbasan.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitetet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI
DAMIAN GJIKNURI

NË MUNGESË DHE ME POROSI

ZËVENDËSMINISTRI

ENIS ALIKO

